VENDIM
Nr. 32, datë 17.1.2024

PËR SHPALLJEN E VITIT 2024 "VITI MBARËKOMBËTAR I 80-VJETORIT TË ÇLIRIMIT" DHE KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE NË KUADËR TË TIJ

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Viti 2024 shpallet "Viti Mbarëkombëtar i 80-Vjetorit të Çlirimit".
2. Në kuadër të vitit dedikuar 80-vjetorit të çlirimit, krijohet Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive (në vijim Komisioni).
3. Komisioni kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe ka në përbërje këta anëtarë:
a) ministrin përgjegjës për punët e jashtme;
b) ministrin përgjegjës për financat;
c) ministrin përgjegjës për arsimin dhe sportin;
ç) ministrin përgjegjës për rininë;
d) ministrin përgjegjës për kulturën;
dh) ministrin përgjegjës për turizmin;
e) ministrin përgjegjës për drejtësinë;
ë) ministrin përgjegjës për punët e brendshme;
f) drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
g) drejtorin e përgjithshëm të Arkivave;
gj) drejtorin e Muzeut Kombëtar;
h) drejtorin e Bibliotekës Kombëtare;
i) drejtorin e përgjithshëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës;
j) përfaqësuesin e kabinetit të Kryeministrit;
k) drejtorin e Agjencisë për Media dhe Informim;
l) drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
ll) drejtorin e Drejtorisë së Protokollit të Shtetit.
4. Me ftesë të kryetarit dhe me pëlqimin paraprak të tyre, në Komision ftohen të marrin pjesë:
- përfaqësues të institucioneve të qeverisjes qendrore;
- përfaqësues të qeverisjes vendore;
- përfaqësues të agjencive, organizatave ose federatave;
- personalitete dhe figura të shquara shqiptare vendase ose në diasporë.
5. Komisioni është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e planit të veprimit e të kalendarit të integruar të veprimtarive, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i këtij vendimi, përcakton llojet e veprimtarive në kuadër të "Vitit Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit", logon përkatëse, e cila do të përdoret në të gjitha dokumentet zyrtare nga të gjitha institucionet publike përgjatë vitit 2024, si dhe burimin e financimit për secilin aktivitet.
6. Kalendari i integruar i veprimtarive, i shoqëruar me kostot financiare, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Komisioni mblidhet me kërkesë të kryetarit dhe sa herë që shihet e nevojshme.
8. Komisioni ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka këto detyra kryesore:
a) përgatit takimet e Komisionit;
b) raporton periodikisht pranë Komisionit për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme të tij;

c) bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna prej Komisionit;

ç) mban procesverbalet dhe harton vendimet e marra nga Komisioni;

d) kryen detyra të tjera që përcaktohen nga kryetari i Komisionit.

9. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komisionit.

10. Ngarkohen Komisioni dhe Drejtoria e Protokollit të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku